

VENDIM
Nr.94, datë 26.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “KESH” SHA PËR TRANSFERIMIN E ASETVE, PËRKATËSISHT
“NËNSTACIONI LANABREGAS”, “NËNSTACIONI BOGOVË”, “NËNSTACIONI
GJANC”, “NËNSTACIONI BUSHAT 110/20KV”, “RRJETI 20 KV KOPLIK”,
“NËNSTACIONI SHKODËR 110/20KV”, “NËNSTACIONI FIER 110/20KV”,
“NËNSTACIONI GJIROKASTËR”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika “1”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e Transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria KESH sh.a. tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)

- Neni 7, pika 1.3 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a. “Për transferimin e aseteve, përkatësisht të “Nënstacionit Lanabregas”; “Nënstacionit Bogovë”, “Nënstacionit Gjanc”, “Nënstacionit Bushat 110/20 kv”, “Rrjetit 20 kv Koplik”, “Nënstacionit Shkodër 110/20 kv”, “Nënstacionit Fier 110/20 kv”, “Nënstacionit Gjirokastër”, tek “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani